



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në përputhje me nenin 47, paragrafi (1), pika 6) dhe me nenin 20, paragrafi (2) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21), Këshilli i Bankës Popullore i Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi

V E N D I M

për ndryshimin e Vendimit për rezervën e detyrueshme

1. Në Vendimin për rezervën e detyrueshme ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 16/23 dhe 171/23), në pikën 6), paragrafi (1), nënparagrafi (3), përqindja: "20%" zëvendësohet me përqindjen: "21%".

2. Në pikën 8), paragrafi (1), nënparagrafi (2), përqindja: "20%" zëvendësohet me përqindjen: "19%".

3. Në pikën 9), paragrafi (1), nënparagrafi (1), përqindja: "80%" zëvendësohet me përqindjen: "81%".

4. Ky vendim hyn në fuqi tetë ditë pas botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe do të zbatohet nga 20 dhjetori 2023 me mbajtjen e rezervës së detyrueshme të llogaritur nga detyrimet e tetorit të vitit 2023.

V nr. 02-31266/2
19 shtator 2023
Shkup

Guvernatorja
dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë së Veriut
д-р. Анита Ангеловска Бежоска